



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 19 qershor 2014  
Nr. ref.:RK644/14

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin nr. KI114/13**

Parashtrues

**Emsale Zoni**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në  
Mitrovicë, Ac. nr. 170/2012, të 24 shtatorit 2012**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Emsale Zoni, me banim në Vushtrri.

### **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja në kërkesë veçanërisht konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, Republika e Kosovës, C. nr. 215/06 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale në Vushtrri), të 3 korrikut 2006, e pranuar nga parashtruesja e kërkesës në një datë të pacaktuar.
3. Megjithatë, vendimi përfundimtar në këtë rast është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/2012, i 24 shtatorit 2012, i pranuar nga parashtruesja e kërkesës në një datë të pacaktuar.

### **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartpërmendura të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.
5. Pa marrë parasysh këtë, parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin kolektiv të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006, për shkak të mospërmbarimit të vendimit.

### **Baza juridike**

6. Kërkesat janë të bazuara në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

### **Procedura në Gjykatë**

7. Parashtruesja e kërkesës ka parashtruar kërkesën më 29 korrik 2013.
8. Më 5 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI114/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI114/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Artur Rama-Hajrizi.
9. Më 12 shtator 2013, kërkesat iu komunikuan Gjykatës Themelore në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
10. Më 26 shtator 2013, Gjykata Themelore në Vushtrri ia dorëzoi Gjykatës Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Vushtrri, E. nr. 273/08, të 21 shkurtit 2008, si dhe të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/12, të 24 shtatorit 2012, të cilës parashtruesi nuk ia ka dorëzuar në fillim.
11. Më 21 nëntor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës në lidhje me dokumentet e dorëzuara nga Gjykata Themelore në Vushtrri.

12. Më 11 shkurt 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

13. Parashtruesja e kërkesës ka qenë e punësuar në Ndërmarrjen shoqërore “Qyqavica” deri në vitin 1992.
14. Sipas dokumenteve të parashtruara, në bazë të Aktgjykimit kolektiv të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006, NSH “Qyqavica” në Vushtrri ka qenë e obliguar t’i kompensojë të ardhurat personale prej vitit 1992 deri më 1999, me kamatë vjetore prej 4.5%, duke filluar nga 29 qershori 2005, deri në pagesën përfundimtare për të gjithë parashtruesit e kërkesës.
15. Parashtruesit e kërkesës kanë parashtruar kërkesë në Gjykatën Komunale në Vushtrri, për ekzekutimin e Aktgjykimit të mëparshëm të Gjykatës Komunale, C. nr. 215/05, të 3 korrikut 2006.
16. Më 5 tetor 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri ka marrë vendim për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006 (Aktvendimi E. nr. 2846/06, i 5 tetorit 2006). Llogaria e NSH “Qyqavica” është bllokuar, dhe “Bankës së Re të Kosovës”, dega në Vushtrri, i është urdhëruar që parashtruesve të kërkesës t’ua paguajë shumën e caktuar, së bashku me kamatën e caktuar.
17. Megjithatë, më 21 shkurt 2008, Gjykata Komunale mori vendim të anulojë procedurën përmbarimore (Aktvendimi E. nr. 273/08).
18. Në Aktvendimin e saj, Gjykata Komunale në Vushtrri arsyetoi vendimin e saj për anulimin e përmbarimit duke iu referuar shkresës së 31 dhjetorit 2007 nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, ku kërkohet nga Gjykata Komunale që “...në lidhje me të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me NSH “Qyqavica”, të anulojë procedurën e përmbarimit, sepse në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/4 përcaktohet që me nxjerrjen e rregulloreve të veçanta për rregullimin e fushave të caktuara përjashtohet LPP-ja (Ligji për procedurën përmbarimore), si dhe është përcaktuar që NSH-ja nuk është në procesin e likuidimit, megjithatë, kreditori mund të realizojë të drejtat e tij në AKM [Agjencia Kosovare e Mirëbesimit] dhe këto kërkesa do të konsiderohen si tituj përmbarimorë, megjithatë në procedurën e likuidimit të ndërmarrjes, kërkesat do të përmbushen nga Komisioni i Likuidimit të NSH-së”.
19. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, E. nr. 273/08, të 21 shkurtit 2009, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.
20. Më 24 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Aktvendimi Ac. nr. 170/12) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, E. nr. 273/08, të 21 shkurtit 2009. Gjykata e Qarkut thekson që “NSH-të janë kompetencë ekskluzive e Dhomës së Posaçme në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

21. Parashtruesja e kërkesës pretendon që ka punuar në NSH “Qyqavica” në Vushtrri deri më 1991, kur forcat serbe e kanë larguar me dhunë nga puna, si dhe e kanë diskriminuar.
22. Parashtruesja e kërkesës pretendon që të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë janë cenuar, sepse ajo ka të drejtë të marrë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Qyqavica”, në kuptimin e kompensimit të të ardhurave të saj personale për periudhën nga viti 1991 deri më 1999. Parashtruesja e kërkesës thirret në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave të të Drejtave të Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

23. Gjykata vëren se, për të gjykuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse ajo i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton që:  
*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. (...)”.*
25. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b), i cili përcakton që:  
*“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi”.*
26. Gjykata vëren se vendimi i fundit i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/12, i 24 shtatorit 2012, i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës në një datë të pacaktuar, ndërsa parashtruesja e ka parashtruar kërkesën në Gjykatë më 29 shtator 2013. Pasi që parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të dorëzojë dëshmi në këtë Gjykatë mbi atë se kur i është dorëzuar vendimi i Gjykatës së Qarkut, kjo gjykatë konsideron që dita në të cilën është publikuar vendimi është dita e dorëzimit, gjegj. 24 shtatori 2012.
27. Gjykata thekson që kushti juridik i zbatueshmërisë së afatit prej katër (4) muajve për parashtrim të kërkesës ka për qëllim të promovojë parimin e sigurisë juridike si dhe të sigurojë palët që rastet që janë nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të trajtohen në afat të arsyeshëm, si dhe që organet dhe palët e tjera të interesuara të mbrohen nga situata të paqartësisë për shkak të afatit të zgjatur kohor (shih, *mutatis mutandis*, P.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikacioni nr. 6638/03, Vendimi i 24 gushtit 2004)
28. Për më tepër, Gjykata rithekson që parashtruesja e kërkesës është e obliguar të informojë Gjykatën për të gjitha rrethanat në lidhje me kërkesën, si dhe mos të mbajë asnjë informatë që i është e njohur. Në të kundërtën, mbajtja apo vënia e

Gjykatës në lajthitje mund të ngrejë çështjen e keqpërdorimit të së drejtës për kërkesë.

29. Gjykata vëren se në këtë rast, parashtruesit e kërkesave nuk e kanë informuar Gjykatën për Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri (E. nr. 273/08, të 21 shkurtit 2008) për anulimin e procedurës së përmbarimit dhe për Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 170/2012, të 24 shtatorit 2012) që të shfuqizojë vendimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Vushtrri. Sjellja e tillë nuk është në përputhje me të drejtën për kërkesë individuale sipas standardeve juridike evropiane. (shih *mutatis mutandis*, Vendimi i GJEDNJ-së *Hadrabova dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* për lejueshmërinë, nr. 42165/02 dhe 466/03, të 25 shtatorit 2007).
30. Në këto rrethana, parashtruesja e kërkesës nuk i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë sa i përket afatit brenda të cilit duhet parashtruar kërkesa në Gjykatën Kushtetuese.
31. Andaj, Gjykata konkludon që kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shkurt 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Altay Suroy

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

